



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN**  
**E TË DHËNAVE PERSONALE**  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 338/1 prot.

Tiranë më 04.02.2026

Lënda: Për bashkërendim të një projektvendimi

**MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**

**Tiranë**

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) ka administruar shkresën tuaj me nr. 210/2 prot., datë 28.01.2026, administruar me tonën me nr.338 prot. datë 02.02.2026, me anë të së cilës dërgoni për bashkërendim projektvendimin “Për përcaktimin e kërkesave për gjurmueshmërinë, si dhe rregullave për elementët, etiketën, procedurën dhe mënyrën e shenjimit dhe gjurmimit”, së bashku me dokumentacionin shoqërues.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së projektvendimit të ridërguar, Zyra e Komisionerit konstaton marrjen në konsideratë të sugjerimeve të dhëna nga ana jonë, me shkresën nr.3271/1 prot., datë 30.12.2025. Në këtë kuadër, e vlerësojmë projektvendimin të hartuar konform legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**